

Zonja dhe zotërinj!

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për Zonjën e Parë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zonjës Elizabeta Gjorgievska, për ftesën në një konferencë të organizuar kaq bukur! Më lejoni gjithashtu të përgëzoj të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre shumë të rëndësishëm. Siç e përmendët tashmë, Shqipëria ka bërë një progres shumë të mirë drejt arritjes së autonomisë trupore për gratë dhe vajzat.

Strategjia jonë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021 – 2030) përfshin, për herë të parë, objektivin specifik të fuqizimit të grave dhe vajzave për të arritur autonominë trupore. Për më tepër, ky objektivi, i mbështetur financiarisht nga qeveria, është i harmonizuar me Planin e Veprimit Gjinor III (të tretë) të fushës së synimeve të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, në lidhje me politikat e qeverisë për aksesin në paisjen me kontraceptivë, këshillimin për planifikimin familjar dhe ofrimin e informacionit online për kontraceptivët, Shqipëria shënon një vlerësim të lartë prej 68.1% siç tregohet në “Politikat për Kontraceptivët” të Atlas Europe, 2023.

Megjithatë, është një lloj paradoksi që në Shqipëri gjatë periudhës 2013 – 2023 përdorimi i kontraceptivëve modernë ka ardhur në rënie nga 11% në 4%, megjithëse 400 qendrat shëndetësore të vendit i ofrojnë ato falas.

Besoj se një nga faktorët kryesorë të kësaj situate është edukimi i pamjaftueshëm i shëndetit seksual për shkak dhe të braktisjes së shkollës. Pra, sipas të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), shkalla e braktisjes së shkollave fillore dhe nëntëvjeçare në Shqipëri është përkatësisht 6.8% dhe 5.5%. Për më tepër, orët e edukimit seksual nuk janë të detyrueshme siç janë në vendet me arritje të avancuara të autonomisë trupore.

Realizimi i autonomisë trupore si dhe përdorimi i kontraceptivëve modernë nga gratë dhe vajzat dëmtohet gjithashtu nga martesat e fëmijëve dhe ato në moshë të hershme.

Më duhet të them se ky problem në Shqipëri është shumë më pak i rëndë sot. Pra, gjatë periudhës 1990 – 2008, 27,2% e martesave përfshinin vajza nën 18 vjeç, ndërsa në vitin 2020 ky numër u reduktua ndjeshëm në 6,4% dhe në vitin 2022 nuk kishte asnjë. Megjithatë, shkalla e martesave që përfshijnë gra vetëm 19 vjeç është ende mjaft e lartë.

Unë besoj fort se për të arritur autonominë trupore, të gjithë ne, përfshirë mediat, duhet të bëjmë shumë më tepër kundër tabuve dhe stigmës në lidhje me edukimin seksual dhe përdorimin e kontraceptivëve.

Më lejoni të përmend se, nën drejtimin e UNFPA-së në Shqipëri, do të kemi shumë shpejt një studim të detajuar mbi çështjet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në autonominë trupore në Shqipëri si dhe masat për arritjen e saj.

Dhe padyshim që diskutimet dhe përfundimet e kësaj Konference do të na ndihmojnë jashtëzakonisht shumë.

Faleminderit!